

27.10.2012

A. nr. 225/2011

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Marije Ademi dhe Salih Toplica, anëtarë, me pjesëmarrjen e Bujar Balajt, procesmbajtës, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëseve Sadif Aranliu, Xhemal Aranliu, Resmije Rrema, Visal Perolli, Salajdin Kastrati, Albina Marku dhe Myezjane Hoxha, të cilët me autorizim i përfaqëson Sadif Arnaliu nga Prizreni, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Qendrore, për kompensimin e dëmit material dhe jo material për shkak të ndërprerjes së pensionit nga marrëdhënia e punës, që nga viti 1999, në lëndën e pensionit, në seancën e mbajtur më datën 08.10.2012 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

A r s y e t i m i

Paditësit me padinë e paraqitur kërkojnë aktivizimin e pensionit të gëzuar nga marrëdhënia në punë para vitit 1999, duke u bazuar në shtypin ditor me të cilin shkrim është kërkuar nga OKB që të dënohet Serbia dhe njëkohësisht të kthehet fondi pensional në Kosovë për kontribuespaguesit deri në vitin 1999. Propozojnë që padia të aprovohet dhe t'iu bëhet kompensimi i dëmit material dhe jo material konform vlerësimeve nga dita e ndërprerjes gjegjësisht nga viti 1999.

Organi i paditur në përgjigje të padisë, propozon që kërkesëpadia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi aktin e kundërshtuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par. 1 të Ligjit për Konflikte Administrative, vlerësoi thëniet në padi dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Qendrore, nuk mund t'ia njoh paditësve kete te drejt sepse Departamenti i Administratës Pensionale i Republikës së Kosovës nuk është trashëgimtare e pensioneve të gëzuara para luftë, nga ish Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor.

